



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:078275

Datë: 02.05.2023

Numri i dokumentit: 04238495

Pml.nr.57/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit N.P., për shkak të veprës penale vrasja e rëndë, nga neni 173 par.1 nënpar.1.12 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe dy veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, nr: 2019:078275 të datës 28.07.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.477/2022 të datës 21.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 6 prill 2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit N.P., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda nr:2019:078275 i datës 28.07.2022 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.477/2022 i datës 21.10.2022 dhe bazuar në nenin 363 par.1 nënpar.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i dënuari,

Lirohet nga akuza

Se më datë 09.11.2015, në intervalin kohor prej orës 14:44 deri 15:19 min., në Bjeshkët e S., komuna e D., pikërisht në vendin e quajtur “K. i L.”, duke qenë se më parë ishte dënuar për veprë penale të vrasjes së rëndë me dashje, e ka privuar nga jeta viktimën tani të ndjerën D.P. nga fshati S. i U., komuna e D., në atë mënyrë që derisa e ndjera ditën kritike ishte duke shkuar në punë në këmbë nëpër rrugët e fshatit në drejtim të fshatit S. i E. dhe kur ofrohet në afërsi të shtëpisë së N.J., kalon i akuzuari me veturën e tij “J. Sh.”, me ngjyrë të kaltër - mbyllët, i cili ndalet e merr viktimën me veturë e më pas vazhdon në drejtim të Bjeshkëve të S. dhe me të arritur tek vendi i quajtur “K. i L.” e privon nga jeta në atë mënyrë që nga arma e tipit të panjohur ka shtënë duke e qëlluar dy herë në kokë dhe largohet nga vendi i ngjarjes, kurse kufoma e së ndjerës është gjetur me datë 27.12.2015 në vendin e ngjarje nga disa kalimtar të rastit,

- me çka kishte për të kryer veprën penale vrasja e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar.1.12 të KPRK-së.

Kurse sa i përket dy veprave penale të mbajtjes në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dënimet e shqiptuara në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj merren si të vërtetuara dhe për të cilat dënime bazuar në nenin 80 të KPRK-së, gjykohet me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 3 (tre) muaj.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës, kurse përfaqësuesi i së ndjerës D.P., për realizimin e kërkesës pasuror - juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin nr:2019:078275 e datës 28.07.2022, të dënuarin N.P. e ka shpallur fajtor për veprat penale: vrasja e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.12 të KPRK-së, dhe dy veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim - burgimi të përjetshëm në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim

prej datës 22.12.2015 deri me datë 06.03.2018 dhe nga data 25.03.2019 e tutje. I dënuari është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 400 (katërqind) €, shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 200 (dyqind) €, si dhe shumën prej 50 € në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse përfaqësuesit e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.477/2022 e datës 21.10.2022, ka aprovuar pjesërisht ankesën e përbashkët të mbrojtësve të të dënuarit, por edhe sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me cilësimin juridik dhe vendimit për dënim në atë mënyrë që për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 par.1 nënpar.1.4 dhe 1.12 të KPRK-së, e ka cilësuar si vepër penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 par.1 nënpar.1.12 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 35 (tridhjetepesë) vjet, kurse dënimet e shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë për veprat penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj i merr si të vërtetuara në atë mënyrë që sipas dispozitës së nenit 42 par.2 të KPRK-së e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 35 (tridhjetepesë) vjet. Ankesa e përbashkët e mbrojtësve të të dënuarit përkitazi me bazat ankimore refuzohet si e pabazuar, ndërsa pjesët e tjera të aktgjykimit janë vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit N.P., avokati Gëzim Kollçaku nga Peja, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe të pandehurin në mungesë të provave ta lirojë nga akuza, apo të anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.39/2023 e datës 14.02.2023, ka propozuar që kërkesa e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

a) Pretendimet e mbrojtësit të dënuarit të paraqitura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 të KPPK-së, meqë nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë provat që vërtetojnë fajësinë e të akuzuarit dhe njëkohësisht nuk ka marrë parasysh dhe as që i ka përmendur dhe arsyetuar provat me të cilat vërtetohet pafajësia e të akuzuarit. Gjykata gabimisht ka interpretuar provat materiale dhe ka potencuar konstatime që shkojnë në dëm të të akuzuarit edhe pse këto konstatime nga askush nuk janë thënë dhe as që janë vërtetuar nga çfarëdo prove materiale. Theksohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është arsyetuar se nga shikimi në video - incizimet e kamerave të sigurisë së shtëpisë së N.J. në fshatin S. të U., shihet se më datë 09.11.2015 në ora 13:44:13 sec., ka kaluar vetura e markës “J. Sh.”, kurse nga kamera e emërtuar si “N.J. - 5”, shihet vetura e ndalur, përkatësisht një vezullim-mbyllje e derës-nisjen e veturës. E që një konstatim i tillë nuk është real meqë rrezja e kamerës automjetin e të akuzuarit e ka kapur në ora 13:44:13 sec., pra nga ky moment ka filluar videoja pasi që nga sekonda 13 fillon ecja e kohës, pra automjeti nuk është ndalur dhe as që është hapur dera e veturës. Fakti se nuk shihet hapja apo mbyllja e derës së veturës vërtetohet edhe nga vet aktgjykimi i konstatuar në faqen 28 pasusi i tretë duke shënuar se: *“Në raportin e AKF-së i datës 08.12.2020 është konstatuar se kamerat në shtëpinë e N.J. kanë incizuar sipas lëvizjes së objekteve në pamjen e kamerave, ndërkaq në kamerën -3 në incizim 13:44:13 sec., nuk vërehet si hapje apo mbyllje e derës”*. Konstatimi tjetër i theksuar në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është se nga video incizimi i marrë nga kamera e sigurisë së G.A., shihet se në ora 14:44:52 sec., kalon vetura “J.Sh.” e konstatuar nga ana e policit hetues dhe se kjo veturë ka karakteristika të njëjta me veturën që ka kaluar pranë shtëpisë së N.J., i cili konstatim është në kundërshtim me deklarimin e ekspertit të AKF-së B.H., i cili ka theksuar faktin se ka punuar në pastrimin, qartësimin dhe kthjellimin e videove incizimeve, por nuk është në kompetencë të tij përcaktimi se a bëhet fjalë për veturë të njëjtë që është regjistruar nga kamerat, duke shtuar faktin

se sipas njohurive të tij në territorin e Kosovës nuk ka ekspert të tillë që të bëjë krahasimin dhe të jap mendim për faktin se në dy pamjet a është e njëjta veturë apo jo. Përkundër kësaj, gjykata e shkallës së parë këto prova të cilat vet i ka nxjerr dhe të cilat vërtetojnë pafajësinë e të akuzuarit, meqë vërtetohet se i akuzuari nuk e ka ndalur veturën e tij afër shtëpisë së N.J. dhe as që ka hipur e ndjera D.P., dhe po ashtu nuk vërtetohet fakti se vetura e regjistruar nga kamera e shtëpisë së N.J. është e njëjta veturë që ka kaluar edhe tek shtëpia e G.A., vet i injoron dhe nuk u jep fare rëndësi dhe të cilat prova i quan eksperiment. Pretendohet se gjykata e shkallës së parë në faqen e 34 të aktgjykimit të saj e ka interpretuar gabimisht ekspertizën e ekspertit të forenzikës B.H., meqë i njëjti nuk ka konstatuar, siç është përshkruar se vetura e markës “Jeep” është e njëjta me veturën e cila shihet në kamerat e shtëpisë së N.J. në ora 13:44:13 sec., meqë një konstatim të tillë nuk e ka dhënë eksperti as në ekspertizë. Ashtu që me këtë rast gjykata e shkallës së parë ka bërë keqinterpretim të provës në fjalë dhe ka shtrembëruar vërtetësinë e provave që kanë shkuar në drejtim të vërtetimit të pafajësisë së të akuzuarit, meqë përmes kësaj prove vërtetohet fakti se i akuzuari nuk ka kaluar fare kah shtëpia e G.A. në orën 14:44:51 sec., përkatësisht nuk ka qenë automjeti i të akuzuarit. Kjo vërtetohet edhe përmes provës së nxjerrë nga vet gjykata e shkallës së parë me rastin e shikimit në vendin e ngjarjes, me ç’ rast me urdhrin e gjykatës është bërë matja e kohës së lëvizjes së veturës zyrtare të policisë së bashku me ekspertin e gjeodezisë dhe është konstatuar se nga shtëpia e N.J. deri te shtëpia e G.A. me shpejtësi mesatare prej 60 km/h është kaluar për 1’18” e që kjo është në kundërshtim me shpejtësinë e lëvizjes së automjetit të të akuzuarit, meqë nga kamera e shtëpisë së N.J. e deri te shtëpia e G.A., sipas video-incizimeve del se kjo rrugë është kaluar për 38 sec., e që kjo vërteton se në asnjë mënyrë automjeti i regjistruar tek shtëpia e G.A. nuk ka mundur të jetë automjeti i të akuzuarit dhe me këtë vërtetohet se automjeti i të akuzuarit nuk ka kaluar fare nga shtëpia e G.A., por lëvizja e tij ka qenë kah “B. i F.” për në varreza. Pra, kjo nuk ka pasur mundësi as teorikisht të ndodhë pasi që duke e ditur se ditën kritike ka pasur qarkullim të veturave në këtë rrugë për shkak të varrimit dhe kalimi për 38 sekonda me automjet të akuzuarit do të duhej të zhvillonte shpejtësinë prej 130km/h. Mirëpo, përkundër kësaj prove e cila vërteton pafajësinë e të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë këto prova të cilat vërteton pafajësinë e të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë këto prova e quan eksperiment dhe gjithashtu arsyeton se diferenca kohore mes automjetit të të akuzuarit dhe automjeti të policisë nuk është diferencë e madhe përkundër faktit se kjo diferencë ishte 40 sec. Pra, vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë pretendohet se janë kontradiktore, meqë kjo provë po të ishte interpretuar në mënyrë të drejtë do të ishte e mjaftueshme që të vërtetohet fakti se i akuzuari nuk ishte personi që e ka marrë të ndjerën për ta dërguar në malet e S., në vendin e quajtur “K. i L.” ku edhe është gjetur trupi i pajetë i të ndjerës.

Në kërkesë, tutje theksohet se gjykata e shkallës së parë në faqen 45 të aktgjykimit të saj ka konstatuar rrethana dhe prova të cilat nga askush nuk janë thënë, konkretisht përkitazi me ekspertizën e ekspertit mjeko-ligjor i cili kinse ka konstatuar se: "*Dita e zhdukjes së D. ishte edhe dita e vrasjes së të njëjtës*", por deklarimi i ekspertit mjeko-ligjor ka qenë se kjo nuk mund të vërtetohet pasi që ka kaluar një kohë e gjatë nga gjetja e kufomës së të ndjerës dhe se një konstatim i tillë nuk është thënë asnjëherë në ekspertizën mjeko-ligjore. Në mënyrë të ngjashme, pra duke keqinterpretuar provat gjykata e shkallës së parë ka vepruar edhe në faqen e 30 pasuesin e parë të aktgjykimit përkitazi me hartografinë e të akuzuarit N.P., nga telefoni i tij me nr. 044/...-... se me datën 09.11.2015 në orën 15:19 min., ka thirr dëshmitarin Z.Z. dhe është aktivizuar antena Z. e cila sipas raportit të Telekomit të Kosovës kjo antenë mbulon vendin ku është gjetur trupi i pa jetë i të ndjerës D.P. dhe kjo sipas gjykatës ka vërtetuar faktin se i akuzuari paska qenë në vendin e ngjarjes ditën kritike më datën 09.11.2015, në orën 15:19 min. Kurse tutje konstatohet se: "*... vendi K. i L. në Bjeshkët e S., mbulohet nga valët e antenës Zll., vërtetohet edhe me raportin e Telekomit të Kosovës të datës 04.05.2021, me rastin e kërkesës së gjykatës për nxjerrjen dhe sqarimin e hartografisë për numrin konkret të telefonit*". Mirëpo, edhe në këto konstatime gjykata këtë provë shumë të rëndësishme e ka keqinterpretuar njoftimin e Telekomit të Kosovës D.D të datës 24.12.2020, duke arsyetuar se vendi ku është gjetur trupi i pajetë të "K. i L." mbulohet me antenën e Z.3. Kurse raporti i dërguar nga ana e zyrës operative ndërlidhëse ka bërë shpjegimin në lidhje me kyçjet e mundshme të antenave të cilat ditën kritike janë aktivizuar e që kjo zyre me datën 05.05.2021 ka përpiluar dhe dërguar një raport në lidhje me kërkesën e gjykatës i cili raport në tërësi eliminon dyshimin se i akuzuari ditën kritike në orën 15:19 min., ka qenë në vendin e ngjarjes, vetëm se është aktivizuar antena Z., ngase në këtë raport thuhet se cellat e mundshme për të realizuar thirrjet janë Z._G_2, de_C._G_3, K._G_3, L._G_3, G._G_3, V._G_3 etj., dhe të gjithë këto antena mund të aktivizohen për realizim të thirrjes sepse pika e përafërt që është marrë në këtë rast është në lartësi të madhe në bjeshkë dhe në atë zonë mund të shërbehet nga sinjale të shumta dhe kur bëhet thirrja ka gjasa që të ndryshon thirrja në cell të ndryshëm, në diferencë të shkurtër kohore, ngase në një cell ku tentohet të bëhet thirrje dhe ai cell ka një problem të shkurtër teknikë, apo një ngarkesë thirrja do të tentohet të bëhet në një cell tjetër. Kurse si fakt është dhënë numri +377-45-...-..., ku shihet që gjithmonë nëse thirrja është bërë në të njëjtin lokacion, është aktivizuar antena V. _G_3 dhe pastaj DE_C._G_3 edhe pse thirrjet janë bërë në diferencë të shkurtër kohore kanë shërbyer dy cella, por nuk është aktivizuar celli Z. Mirëpo për çudi edhe pse kjo provë është nxjerrë me kërkesën e gjykatës së shkallës së parë, kjo provë fare nuk përmend konstatimet nga ky raport, dhe për më tepër, nuk përmendë se kjo provë ekziston, edhe pse kjo me siguri eliminon dyshimin se ditën

kritike i akuzuari në orën 15:19 min., ka bërë thirrje nga vendi i ngjarjes pasi që qenka aktivizuar antena Z. Në vazhdim pretendohet se gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësim të gabuar edhe për faktin se prej rrugës kryesore P. - D., deri tek vendi ku është gjetur trupi i pajetë rruga ishte e kalueshme dhe lehtë mund të shkohej me vetura të llojit "J.". Por i cili konstatim është tërësisht i pasaktë, meqë kur vet trupi gjykues ka dalë në vendin ku është gjetur trupi i pajetë i D.P. ka konstatuar në procesverbal se nga vendi deri ku mund të arrijë automjeti e deri te vendi ku është gjetur trupi i pajetë i D.P. është një largësi prej 80 metrash, të cilat mund t'i kalosh vetëm në këmbë e kurrësi edhe me automjet, kurse largësia prej shtëpisë së J., deri te vendi ku është gjetur trupi i pajetë, është diku 6-7 kilometra. Pretendohet se për faktet vendimtare në këtë çështje penalo- juridike, gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që të jap arsye të mjaftueshme e të bazuara në prova dhe shkresa të lëndës, por më shumë është marrë me përshkrimin e deklaratave të dëshmitarëve, me konstatime të cilat janë në kundërshtim me vetë provat materiale, me konstatimet të cilat nuk janë dhënë me asnjë provë, duke minimizuar provat që vërtetojnë pafajësinë e të akuzuarit dhe pa i cekur fare provat në shkresat e lëndës e të cilat vërtetojnë pafajësinë e të akuzuarit. Pastaj, në kërkesë janë paraqitur pretendime rreth mospërputhjes mes aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë datë 29.10.2021 me të cilën ishte aprovuar ankesa e mbrojtësve dhe çështja është kthyer në rigjykim si dhe aktgjykimit të të njëjtës gjykatë datë 21.10.2022 me të cilën pjesërisht është aprovuar ankesa e mbrojtjes e me të cilin aktgjykim i akuzuari është shpallur fajtor dhe është dënuar me burgim prej 35 viteve, e që të dyja janë marrë nga po i njëjti kolegji, por që janë vendime kontradiktore. Së pari, gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin e datës 29.10.2021 me të cilin çështja është kthyer në rigjykim në faqen e tetë ka potencuar se aktgjykimi i shkallës së parë mbështetet në prova që nuk janë proceduar fare në seancën e shqyrtimit gjyqësor gjë që parashihet shprehimisht sipas dispozitave të nenit 361 të KPP-së, ku thuhet se aktgjykimi mbështetet vetëm në prova të proceduara në seancën e shqyrtimit kryesor, kurse nga përmbajtja e procesverbalit të seancës së shqyrtimit gjyqësor, del se i akuzuari është mbrojtur në heshtje. Mirëpo në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar gjatë dhënies së arsyeve për faktet vendimtare, gjykata e shkallës së parë thirret edhe në deklaratat e të akuzuarit dhe atë duke potencuar se deklaratat e dhënë në polici dhe prokurori, mirëpo deklaratat në fjalë nuk janë lexuar dhe as prezantuar fare në seancën e shqyrtimit gjyqësor që të dihet përmbajtja e tyre, që do të thotë se arsyetimi mbështetet në prova që nuk janë proceduar fare në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ngase sikurse rezulton nga shkresat e lëndës i akuzuari kishte dhënë tri deklaratat gjatë procedurës hetimore, dy në polici e një në prokurori ku në polici deklaratën e parë e ka dhënë në cilësinë e dëshmitarit më datë 22.12.2015, ndërsa të dytën serish në polici më datë 23.12.2015 në cilësi të dyshuarit, prandaj tani nuk mund të rezultojë e qartë se

në cilën deklaratë e ka mbështetur arsyetimin e saj, sidomos kur është fjala për faktet dhe rrethanat vendimtare për këtë çështje penalo-juridike. Mirëpo, përkundër faktit se gjykata e shkallës së parë i ka bërë të njëjtat shkelje esenciale të cilat i ka potencuar si më lartë, gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e datës 21.10.2022 në faqen gjashtë dhe shtatë të njëjtat shkelje fare nuk i vlerëson, por i mbështetë këto deklaratë, pa i cekur datat, pa u lexuar fare këto deklaratë në gjykatë, edhe pse është dhënë deklarata në cilësi të dëshmitarit e jo të pandehurit. Për më tepër, këto shkelje potencohet se nuk janë shkelje esenciale, e që në disa pjesë të këtij aktgjykimi potencon se kinse i akuzuari nuk i ka kontestuar disa rrethana e që këto konstatime nuk janë të vërteta nga fakti se i akuzuari as në polici, e as në prokurori, e as në shqyrtimin e parë gjyqësor të mbajtur në vitin 2018 nuk i ka cekur këto pretendime, siç gabimisht i ka cekur gjykata e shkallës së dytë. Më tutje në kërkesë janë paraqitur pretendime përkitazi me konkludimet e gjykatës së shkallës së dytë, por të cilat pretendime janë ri përsëritje e pretendimeve të cilat janë shënuar në pjesën e epërme të pretendimeve të paraqitura.

b) Gjetjet e kësaj gjykate përkitazi me pretendimet e mbrojtësit në kërkesë

Edhe pse mbrojtësi në kërkesë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, por se bazuar në provat e administruara në këtë çështje gabimisht është zbatuar ligji penal kur i dënuari është shpall fajtor për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar.1.12 të KPRK-së. Pra, provat e administruara janë interpretuar në mënyrë të gabueshme dhe janë nxjerr konkludime të gabuara, dhe atë në dëm të të dënuarit, andaj, kjo rrjedhimisht e bën të mundur ndryshimin e aktgjykimeve të dy instancave më të ulëta gjyqësore duke e vendosur këtë çështje në mënyrë meritore.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se meqë në shqyrtimet e kaluara gjyqësore të të dy instancave më të ulëta gjyqësore, janë marrë në konsideratë të gjitha provat e mundshme për vendosjen e kësaj çështje penale, kjo gjykatë duhet t'i jap epilog kësaj çështje penale, për këto arsye: kjo çështje penale ka filluar prej datës 24.12.2015 (aktvendimi për fillim të hetimit), përkatësisht datës 08.06.2017 (kur është paraqitur aktakuza), dhe janë marrë katër aktgjykime nga gjykatat e shkallës së parë dhe po aq nga ana e gjykatës së shkallës së dytë dhe gjithashtu edhe një aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës, që del se në këtë çështje penale janë marrë nëntë aktgjykime, dhe kur kësaj i shtohet fakti se janë marrë edhe vendime të ndryshme, del se janë tejkaluar standardet kohore të përcaktuar me KPP-së, me nenin 6/1 të KEDNj, por edhe afati

i arsyeshëm kohor për përfundimin e një procesi gjyqësor i aplikuar nga ana e GJEDNj, të konstatuara në rastet: Cesarini kundër Italisë, Ollson kundër Suedisë, Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë, Marini kundër Shqipërisë, Huseinoviç kundër Sllovenisë dhe Hokanen kundër Finlandës.

Gjykata Supreme e Kosovës në tërësi pajtohet me konkludimet e nxjerra nga dy instancat gjyqësore se në rastin konkret sipas asaj që ceket në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë nuk rezultojnë të jenë kontestuese rrethanat objektive të rastit dhe atë se: e ndjera D.P., me datë 09.11.2015 kishte dalë nga shtëpia e saj për të shkuar në punë dhe të njëjtën datë edhe është zhdukur. Kufoma e saj ishte gjetur me datë 17.12.2015 në vendin e quajtur “K. i L.”, se e njëjta ishte privuar nga jeta duke u qëlluar dy herë në pjesën e kokës, me një revole të tipit të panjohur. Mirëpo nga këto rrethana, ashtu siç është pretenduar edhe në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, del se kontestuese janë rrethanat subjektive përkatësisht fakti se a ishte kryerësi i veprës penale i pandehuri dhe ishte pikërisht ky aspekt që bëri dallimin mes interpretimit të bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe të cilin konstatim e kishte pranuar edhe gjykata e shkallës së dytë në njërën anë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës në anën tjetër.

Gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore aktgjykimet e tyre dënuese i mbështesin në disa prova materiale të cilat do të elaborohen hollësisht në këtë aktgjykim: së pari në lëvizjen e automjetit të të pandehurit në ditën kritike, pra, me datë 09.11.2015 në ora 13:44:13 sekonda, dhe e cila lëvizje regjistrohet nga kamera e vendosur në shtëpinë e N.J., me ç’ rast gjykata e shkallës së parë ka paraqitur tri konkludime të cilat nuk janë në harmoni me provat e administruara dhe atë e para se automjeti i të pandehurit ishte ndalur, se ishte hapur dhe mbyllur dera e automjetit dhe pastaj në të kishte hyrë e ndjera D.P.

Mirëpo, këto konstatime të gjykatës së shkallës së parë nuk janë të qëndrueshme dhe të bazuara në provat që gjenden në shkresat e lëndës, meqë faktet e lartë cekura nuk janë vërtetuar me asnjë provë: së pari *se vetura e të pandehurit ishte ndalur*, dhe kjo mos ndalje e veturës vërtetohet përmes shikimit në video-incizim pasi që koha e aktivizimit të kamerës fillon të ec gjatë tërë kohës, pra duke u nisur nga 13:44:13 sec., e tutje deri në 13:44:28 sec., *fakti se dera e veturës nuk ishte hapur dhe mbyllur*, përveç që vërtetohet përmes shikimit në video-incizim, gjithashtu vërtetohet përmes raportit të AKF-së të datës 08.12.2020, ku është konstatuar se kamerat e vendosura në shtëpinë e N.J., janë aktivizuar me lëvizje të objekteve, ndërkaq në incizimin e “kamerës-3”, nuk vërehet hapja apo mbyllja e derës së veturës.

Kurse, fakti i tretë dhe më i rëndësishëm ishte *se e ndjera a kishte hipur në automjetin e të pandehurit* dhe i cili fakt nuk është vërtetuar as edhe me një provë të vetme të drejtpërdrejtë, por as me ndonjë provë rrethore. Provat që nuk vërtetojnë hipjen e të ndjerës në automjet janë të shumta, por meqë ky është fakt vendimtar në këtë çështje penale, atëherë do të vlerësohen të gjitha provat vendimtare që vërtetojnë të kundërtën e arsyetimit të gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore. Fillimisht asnjë nga dëshmitarët e dëgjuar nuk ka pohuar faktin se e ndjera kishte hipur në automjetin e të pandehurit, dhe për tu mos mjaftuar me dëshmitë e dëshmitarëve, kjo nuk vërtetohet as nga provat materiale, përkatësisht nga raporti i laboratorit të FBI-së në Virgjinia të SHBA, me nr...-SRv...-..., numri i laboratorit ...-...-. i datës 06.07.2016, ku konstatohet se nuk është provuar se qimet e flokut apo qimet e tjera që janë tërheqë nga vetura e të akuzuarit të kenë çfarëdo lidhje me viktimën D.P.. Përjashtimin e mundësisë së e ndjera ishte në automjetin e të dënuarit e bën edhe raporti i ekspertizës nga Laboratori i Kriminalistikës të TNP-së në Ankara të T., me numër referues YDPO-...-...-...-DG i datës 16.05.2015, sipas së cilit vërtetohet se nga shikimi në incizime nuk ka mundur të bëhet identifikimi i tabelave si dhe identifikimi i personave në automjet.

Gjithashtu edhe gjykata e shkallës së dytë përveç që i mbështet të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë, konkludon gabimisht disa fakte të rëndësishme e veçanërisht faktet e konstatuara në faqen e pestë të aktgjykimit të saj se: *“...fakte këto dhe rrethana që pjesërisht nuk i konteston as vet i akuzuari, pra përkitazi me faktet se i akuzuari e mori në automjetin e tij Xh., tani të ndjerën D.P. dhe vazhdoi rrugën për në drejtim të L.J., ku edhe kalon pranë shtëpisë së N.J. dhe vazhdon përball shtëpisë së G.A., ku më pastaj tani e ndjera edhe është gjetur e vdekur në vendin e quajtur K. i L., që gjendet në distancë jo të largët nga vendi ku i akuzuari e mori tani të ndjerën D.P., me automjetin e tij...”*. Mirëpo, konstatimet e cituara më lart, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë në tërësi të paqëndrueshme edhe pa asnjë mbështetje në shkresat e lëndës e aq më pak të pohuara nga ana e të pandehurit, i cili në të gjitha deklaratimet e tij ka mohuar kryerjen e veprës penale, pra një përshkrim i tillë është në tërësi imagjinar që nuk korrespondon me provat e administruara.

Gjykata e shkallës së parë tutje në aktgjykimin e saj ka arsyetuar hyrjen e të ndjerës në automjetin e të pandehurit dhe të cilën rrethanë del se e ka vërtetuar përmes dëshmisë së dëshmitarit Q.J. e të cilës dëshmi i jep një rëndësi të veçantë duke e bërë përshkrimin e saj në faqe 33, 36 dhe 37 të aktgjykimit. Mirëpo, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se përkundër faktit se dëshmia e përshkruar theksohet se është e dëshmitarit Q.J. në fakt përshkruhet deklarimi i dëshmitarit tjetër A.M.. Kjo mënyrë e zëvendësimit të dëshmisë së Q.J., me dëshminë e A.M., është e diskutueshme dhe ngre disa probleme të natyrës ligjore.

Së pari, është evident fakti se dëshmitari Q.J. nuk ishte dëgjuar fare gjatë procedurës hetimore dhe dëshmia e tij për herë të parë ishte dhënë me rastin e rigjykimit të çështjes në Gjykatën Themelore në Pejë dhe dëgjimi i tij i dytë në shqyrtimin e parafundit gjyqësor në Gjykatën Themelore në Ferizaj. Dëshmitari Q.J. gjatë dy dëgjimeve të tij gjatë shqyrtimeve gjyqësore nuk ka dhënë asnjë informatë të rëndësishme për veprën penale, për kryerësin dhe rrethana tjera të rëndësishme për procedurën penale, e aq më pak të vërtetojë faktin kryesor të kësaj çështje për hyrjen e të ndjerës në automjetin e të pandehurit. I njëjti pos që pohon faktin se ishte personi që shihej në incizimin e kamerës së shtëpisë së N.J., tutje në tërësi mohon se ishte takuar dhe kishte biseduar me dëshmitarin tjetër përkatësisht zyrtarin policor A.M. Për më tepër, dëshminë e dhënë nga dëshmitari A.M. dëshmitari Q.J. e mohon edhe gjatë ballafaqimit të drejtpërdrejtë me dëshmitarin A.M. (në dy seanca gjyqësore – në shqyrtimin gjyqësor të datës 19.11.2018 në Gjykatën Themelore në Pejë dhe në shqyrtimin gjyqësor të datës 22.10.2020 në Gjykatën Themelore në Ferizaj), duke qenë konsistent në dëshminë e tij se dëshmitarin A.M., për herë të parë e kishte takuar gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Themelore në Pejë.

Edhe pse qëndron fakti se zyrtari policor - dëshmitari A.M. kishte përpiluar raport zyrtar për bisedën mes tij dhe dëshmitarit Q.J., veprimi i gjykatës së shkallës së parë del të shkojë një hap më tutje dhe në fakt dëshminë e dëshmitarit Q.J. e zëvendëson në tërësi me dëshminë e dëshmitarit A.M., pra, thënë më ndryshe dëshmitari A.M. dëshmoi në tërësi për ngjarjen e dëgjuar nga dëshmitari Q.J. përkundër që kjo u mohua në tërësi nga ana e dëshmitarit Q., dhe për më tepër, gjykata e shkallës së parë kësaj dëshmie indirekt i dha një rëndësi vendimtare. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nuk ka dispozitë ligjore për të zëvendësuar një dëshmi të një dëshmitari me dëshminë e dëshmitarit tjetër dhe nuk ishte në autoritetin e gjykatës së shkallës së parë zëvendësimi i kësaj dëshmie, meqë, kjo çështje përveç se nuk ka mbështetje në asnjë dispozitë ligjore është e diskutueshme edhe për faktin se përmes kësaj dëshmie vërtetohet një fakt vendimtar, andaj përpjekja që kjo të vërtetohet përmes një dëshmie indirekte është e pazakontë dhe nuk gjen mbështetje ligjore. Dëshminë e dëshmitarit A.M., e vënë në pikëpyetje edhe aspekte tjera, fillimisht pas përpilimit të raportit ...-DC-... të datës 21.12.2015 nuk e bëri publik emrin e këtij dëshmitari, përkatësisht e prezantoi vetëm si dëshmitar anonim deri në shqyrtimin gjyqësor të datës 19.11.2018 kur edhe u zbulua identiteti i tij, bisedën e zhvilluar me këtë dëshmitar e bëri vetëm me të, pra, pa praninë edhe të ndonjë personi tjetër (dëshmia e tij në faqen 57 të shqyrtimit gjyqësor të datës 16.11.2020) dhe pa e njoftuar për këtë bisedë as edhe kolegun e tij zyrtarin tjetër policor V.K., i cili ishte hetuesi kryesor i këtij rasti dhe kur këtyre rrethanave u shtohen edhe rrethana tjera veçanërisht duke pasur parasysh faktin se dëshmitari A.M. ishte personi që ndërmoi hetimet fillestare në këtë rast dhe që për bisedën e tij dhe dëshmitarit Q.J. nuk e bëri as përpjekjen minimale që dëshminë e këtij dëshmitari ta konvertojë në

provë sipas dispozitave ligjore, përkatësisht ta marr në pyetje si dëshmitar me qëllim të përdorimit eventual në fazat e mëvonshme të procedurës penale. Në fakt dëshmitari A., e ka pas rastin që për dëshmitarin Q. në atë kohë anonim ta njoftoj gjykatën e shkallës së parë qysh në shqyrtimin fillestar, pavarësisht edhe pse u dëgjua në cilësi të dëshmitarit, nuk e ka dha as edhe një informacion lidhur me njohuritë e tij për dëshmitarin anoni, që më vonë ka dalë të jetë dëshmitari Q.J. Pastaj, vet shprehja e përdorur nga ana e gjykatës së shkallës së parë “dëshmitar anonim” nuk përkon me shprehje adekuate pasi që për tu shpallur dëshmitar anonim një person duhet ndjekur procedurën e përcaktuar (nenet 221 dhe 223 të KPP-së) dhe këtë status mund ta njoh vetëm gjykata dhe nuk është në kompetencën e zyrtarëve policor dhënie e këtij statusi dëshmitarit. Të gjitha këto fakte në tërësinë e tyre gjithsesi e bëjnë mjaft të diskutueshëm rolin e A.M. si dëshmitar kredibil dhe i besueshëm, siç e cilësoi gjykata e shkallës së parë dhe kjo duke e ndërlidhur me faktin se ky dëshmitar ishte personi i kyçur në veprime operative të këtij rasti.

Tutje, arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë nuk gjen asnjë mbështetje në provat e administruara, përkatësisht përshkruan faktet që janë në kundërshtim të plotë me shkresat e lëndës, siç është konstatuar në faqen 33 të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ku konstatohet se: *“...vërehet që mbyllet dera e veturës nga ana e majtë dhe vetura nisat në fillim me shpejtësi normale të nisjes dhe menjëherë shihet qartë përmes video incizimit se me të madhe rritet shpejtësia e lëvizjes se veturës...”* për të vazhduar tutje *“...dhe atë në ora 13:44 e që brenda periudhës kohore deri në ora 14:30 nuk shihet asnjë veturë duke lëvizur në të njëjtin drejtim...”*. Por, që të dy këto konstatime nuk janë të qëndrueshme dhe pa asnjë mbështetje në shkresat e lëndës, së pari me asnjë provë nuk konstatohet ndalja e veturës e as nisja e saj e aq më pak hapja dhe mbyllja e derës së veturës, dhe i cili fakt vërtetohet përmes raportit të AFK-së të datës 02.12.2020, ku konstatohet se nuk vërehet hapje apo mbyllje e derës. Kurse fakti i kalimit të veturave tjera në intervalin kohor 13:44 -14:30, vërtetohet përmes një sërë provash materiale të marra nga incizimet e kamerave të shtëpisë së N.J. dhe atë nga shënimet e raportit të policisë të datës 17.12.2015 e konfirmuar edhe me 10 (dhjetë) fotografi (gjashtë të automjetit G.Ch. dhe katër të automjetit B.), ku është konstatuar lëvizja e së paku edhe një veture të tipit B., dhe atë në ora 13:52:24 në drejtim të njëjtë kah ka lëvizur vetura e të pandehurit. Për më tepër, konstatimi i faktit se prej orës 13:44-14:30 nuk kanë lëvizur automjete tjera është në kundërshtim me vet konstatimet e gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 24.05.2022, me ç’ rast në faqen 5, 6 dhe 7 është konstatuar se kamerat e sigurisë nuk janë shikuar deri në këtë kohë, përkatësisht “kamera 1” përfundon së shikuari në ora 14:02:20, “kamera 2” përfundon së shikuari në ora 13:44:31 sec., kurse “kamera 3” përfundon së shikuari në ora 14:02:23 sec., andaj për Gjykatën Supreme të Kosovës është pa asnjë mbështetje në prova fakti i potencuar në aktgjykim se prej orës 13:44 -14:30 min. nuk ka

kaluar asnjë automjet tjetër, kur koha pas orës 14:44:23 sec., as që është shikuar në shqyrtimin gjyqësor të datës 24.05.2022, andaj, për Gjykatën Supreme të Kosovës është e paqartë se ku e mbështetë gjykata e shkallës së parë këtë arsyetim.

Duke vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me video incizimin e regjistruar nga kamera e shtëpisë së G.A., Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me konkludimet e dy gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore, meqë arsyetimi i tyre është në kundërshtim të plotë me provat e administruara, dhe i pa mbështetur në provat që gjenden në shkresat e lëndës. Vërtetimi i faktit se a kaloi vetura e të pandehurit kah shtëpia e G.A., gjithashtu është një ndër faktet vendimtare në këtë çështje penale, meqë nuk është kontestues fakti se me datë 09.11.2015 në ora 13:44:51, kishte kaluar një veturë e tipit “J.” e ngjashme me veturën e të pandehurit dhe për të cilën çështje gjykata e shkallës së parë theksoi se: “... *kjo veturë është e njëjta me veturën siç ishte regjistruar me kamera te shtëpia e N.J., përkatësisht vetura e të pandehurit...*” Por ky konstatim i gjykatës së shkallës së parë nuk gjen mbështetje në provat e administruara dhe atë fillimisht nga mbrojtja e të pandehurit ku theksohet faktin se nuk kishte kaluar kah kjo shtëpi, por pasi që kishte kaluar shtëpinë e N.J. ishte kthyer në të majtë dhe kishte shkuar kah bunari i fushës dhe te varrezat e fshatit S. Natyrshëm që Gjykata Supreme e Kosovës nuk u mjaftua për vërtetimin e kësaj rrethane vetëm përmes mbrojtjes së të pandehurit, por kjo është ndërlikur edhe me prova tjera të administruara nga gjykata e shkallës së parë, pra nga ekspertiza e ekspertëve të forenzikës, ashtu që ekspertët përmes metodave të përdorura të kthjellimit, qartësimit dhe zmadhimit të imazheve të incizimeve dhe me qëllim të ardhjes në përfundim për vërtetimin e faktit nëse vetura e regjistruar te kamera e shtëpisë së N.J. ishte vetura e njëjtë e regjistruar edhe nga kamera e shtëpisë së G.A. Por përkundër kësaj nuk është arritur në përfundim të sigurt se vetura e njëjtë ka kaluar edhe kah shtëpia e G.A., kurse eksperti i forenzikës B.H. nuk kishte konsideruar vetën kompetent për të bërë këtë krahasim, kurse edhe eksperti i komunikacionit nuk e kishte konsideruar vetën kompetent në këtë çështje.

Por, kjo çështje është trajtuar tutje me rastin e daljes së gjykatës së shkallës së parë në vendin e ngjarjes duke angazhuar edhe ekspertë të gjeodezisë me qëllim të matjes së distancës së dy shtëpive (N.J. dhe G.A.) dhe koha e nevojshme për të kaluar këtë distancë. Megjithatë, gjetjet e gjykatës së shkallës së parë nuk përkojnë me vërtetësinë e provave që janë nxjerr ditën kur është bërë dalja në vendin e ngjarjes. Meqë, siç del nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, i cili ka bërë matjen e largësisë mes pikave, vendit të quajtur “D.”, (pika 1), te vendi i pemës në anën e majtë të rrugës (pika 2), hyrja e shtëpisë së N.J. (pika 3), kurse në ekspertizën e tij të datës

25.05.2022, ka paraqitur të dhëna të detajuara për largësinë e pikave dhe po ashtu është bërë edhe vozitje me automjet për të bërë matjen nga pika fillestare (2) pema në anën e majtë të rrugës e deri te shtëpia e G.A. e që nga kjo vozitje është realizuar me shpejtësi mesatare 40-60 km/h dhe ka rezultuar se rruga është kaluar në kohë prej 1'18":01 (e vërtetuar edhe nga video-incizimi në vendin e ngjarjes). Marrja e kësaj prove në vendin e ngjarjes është bërë me qëllim të matjes së distancës dhe kohës së lëvizjes së automjetit dhe me qëllim të eliminimit të dilemave përkitazi me kohën që nevojitet për të kaluar nga pika (2) pema në anën e majtë të rrugës deri te shtëpia e G.A., dhe përmes kësaj është vërtetuar fakti se prej vendit pema deri te shtëpia e N.J. distanca ka qenë 449,97 m., kurse distanca mes shtëpisë së N.J. dhe G.A. ka qenë 53,329 m. Por e rëndësishme përmes kësaj provë është vërtetimi i kohës së kaluar me automjet prej vendit të quajtur "Pema" e deri te shtëpia e G.A., e cila kohë sipas matjeve në vendin e ngjarjes rezulton të jetë 1'18":01 dhe kjo duke e krahasuar me lëvizjen e automjetit të tipit "J." ditën kritike që kjo rrugë sipas kamerave të dy shtëpive del se është kaluar për vetëm 38" nga ora 13:44:13-13:44:51. Atëherë kjo diferencë në kohë në asnjë rrethanë nuk mund të thuhet se: "...nuk ishte diferencë e madhe në kohë...", siç gabimisht konstaton gjykata e shkallës së parë. Por, sipas Gjykatës Supreme të Kosovës, kjo paraqet një diferencë prej 40 sekonda, meqë sipas një përllogaritje të thjeshtë për tu kaluar kjo rrugë për "38" sekonda automjeti i të pandehurit duhet të lëvizte me shpejtësi rreth 130km/h, e që mundësia e lëvizjes me këtë shpejtësi nëpër rrugë të fshatit do të ishte e dukshme edhe përmes kamerave, por edhe përmes personave tjerë që kanë qenë duke lëvizur në ditën kritike, gjithsesi një faktor shtesë i pamundësisë së lëvizjes me këtë shpejtësi është edhe rruga e ngushtë dhe frekuentimi i automjeteve për shkak të pjesëmarrjes së personave në varrimin e Sh.Z.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me konkludimet tjera të nxjerra përkitazi me këto prova nga ana e gjykatës së shkallës së parë, meqë kjo dalje në vendin e ngjarjes nuk është eksperiment, por ishte udhëzim i gjykatës së shkallës së dytë sipas aktvendimit të saj PAKR.nr.366/2021 të datës 29.10.2021 dhe kjo ishte një provë që do të duhej të shqyrtohej në lidhmëni me provat e tjera dhe jo të vlerësohej si e shkëputur, përndryshe është detyrim i gjykatës që secilën provë ta trajtoj në mënyrë të njëjtë dhe pa i dhënë përparësi njëres provë ndaj tjetres dhe aq më pak të bëhet ndarja në prova dhe eksperimente, siç ka vepruar gjykata e shkallës së parë dhe të cilin arsyetim e ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së dytë. Gjithsesi, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka kontradiktë të thellë përkitazi me këto prova të marra në vendin e ngjarjes dhe ekspertizën e gjeodetit të datës 25.05.2022, deri sa në disa raste në aktgjykimin i quan eksperimente, në faqen e 14 të aktgjykimit i liston si prova të prezantuara dhe atë,

procesverbalin e shikimit në vendin e ngjarjes në fshatin S. të U. dhe në Bjeshkët e fshatit S. i U., vendi “K. i L.”, me video- incizim dhe fotografi dhe gjithashtu edhe ekspertizën gjeodezike të ekspertit Z.E. Gjithsesi, kjo provë e ndërlidhur edhe me provat tjera e përjashton mundësinë e kalimit të veturës së të pandehurit rreth shtëpisë së G.A. dhe e përforcon argumentin se lëvizja e tij ishte bërë kah shtëpia e N.J. për të vazhduar te varrezat e fshatit S., meqë nuk ishte e mundur sipas matjeve të bëra që distanca prej pemës-afër shtëpisë së N.J. deri te shtëpia e G.A. të kalohet për kohën prej 38 sekonda.

Në vijim të këtij aktgjykimi Gjykata Supreme e Kosovës do të paraqet disa mospajtime me të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi vendin e gjetjes së trupit të të ndjerës. Bazuar në shkresat e lëndës dhe raportin e policisë, nr...-DC-... ref.2015-HRP-119 të datës 17.12.2015, del se trupi i të ndjerës ishte gjetur me datë 17.12.2015 në vendin e quajtur “K. i L.” dhe se në këtë raport ishte theksuar fakti se nga vendi ku ishte gjetur trupi i pajetë i të ndjerës është në largësi prej 80 metra larg nga pika e degëzimit të kësaj rruge aty pranë rrugës është një rrugë tjetër e cila ka pjerrtësi mesatare e që shpie në pyll në drejtim të lindjes duke vazhduar nëpër këtë rrugë rreth 20 metra larg në krahun e djathtë shihet trupi i pajetë. Megjithëkëtë, gjykata e shkallës së parë këtë raport për vendin ku u gjet trupi i të ndjerës nuk e merr fare parasysh dhe me këtë i anashkalon edhe disa rrethana të rëndësishme për kryesin e kësaj vepre penale, në rend të parë se si arriti i pandehuri që prej automjetit të tij ta dërgon të ndjerën në vendin ku ishte gjetur trupi i saj. Kjo gjithsesi është e rëndësishme duke e ndërlidhur edhe me gjendjen fizike të të pandehurit që nga shkresat e lëndës del se kishte vështirësi në të ecur, (duke u referua në të dhënat personale në prokurori, aktgjykimin e dytë të Gjykatës Themelore në Pejë, deklarin e disa dëshmitarëve: S.J. dhe T.P., dhe thirrja e Komisionit mjekësor për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuar ku është thirrur i pandehuri që të paraqitet në këtë komision me qëllim të vlerësimit për të bërë vazhdimin e pensionit të personit me aftësi të kufizuar dhe i cili fakt konfirmohet edhe nga gjykata e shkallës së dytë e cila në aktgjykimin e saj gjendjen shëndetësore të të akuzuarit e çmon si rrethanë lehtësuese duke konstatuar se: “...i njëjti për shkaqe shëndetësore nuk mund të ecë në mënyrë normale, pra pa përdorimin e shkopit për ecje...”).

Andaj, nga këto rrethana të konstatuara lindë një pyetje e thjeshtë e cila asnjëherë nuk është trajtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta gjyqësore se a pati mundësi objektive që i pandehuri të kryejë këtë veprë penale duke marrë parasysh gjendjen e tij fizike në njërin anë dhe gjendjen fizike të të ndjerës në anën tjetër (person në moshë të re dhe me gjatësi rreth 1.70 cm.- bazuar në të dhënat nga shkresat e lëndës) dhe këto dy rrethana duke i ndërlidhur me vendin ku pretendohet

se ishte kryer vrasja, vend malor dhe në të dy anët e rrugës e rrethuar me shkurre e drunjtë të lartësive të ndryshme (të vërtetuara nga raporti i këqyrjes në vendin e ngjarjes i skicuar, fotografitë e vendit ku u gjet trupi i pajetë i të ndjerës dhe video-incizimi me rastin e shikimit në vendin e ngjarjes). Pra, gjykata e shkallës së parë do të duhej që bazuar në këto rrethana të vinte në përfundim se si arriti i pandehuri që të ndjerën ta nxjerr nga vetura e tij të e dërgojë në vendin e ekzekutimit dhe ta ekzekutojë atë me dy plumba në kokë. Por, këto rrethana janë heshtur dhe kanë mbetur pa përgjigje në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe kjo është në kundërshtim edhe me përshtimin faktik të dispozitivit të aktgjykimit të kësaj gjykate dhe në kundërshtim edhe me ekspertizën e ADN e përpiluar nga ana e AFK-së e datës 15.02.2016 në të cilën është konstatuar se në vendin e ngjarjes ku ishte gjetur trupi i të ndjerës nuk ka përputhshmëri me mostrat e marra të të pandehurit.

Në këtë çështje penale një ndër provat më të rëndësishme që është administruar nga ana e gjykatës së shkallës së parë ka qenë telefonata e të pandehurit ditën kritike, pra me datë 09.11.2015 në ora 15:19, me ç' rast për realizimin e kësaj telefonate ishte aktivizuar antena Z., që ishte në afërsi të vendit ku ishte gjetur trupi i të ndjerës dhe gjykata e shkallës së parë ka marrë si fakt të vërtetuar se aktivizimi i kësaj antene paraqet provë të sigurt se i pandehuri në këtë kohë ishte në këtë vend dhe me këtë edhe kryerës i kësaj vepre penale. Por, gjykata e shkallës së parë - Gjykata Themelore në Ferizaj, duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës ka urdhëruar zyrtarët policor për dalje në vendin e ngjarjes, përkatësisht në vendin "Kroi i Lajthisë" dhe nga aty të realizohen thirrje telefonike nga numri i telefonit 045-...-... në numrin e telefonit 045-...-... dhe të cilat veprime janë realizuar me datë 27.11.2020, kurse pastaj është përpiluar raport nga ana e PTK-Vala për mbulimin e kësaj zone me antena për aktivizim të thirrjeve telefonike. Nga i cili raport është vërtetuar se aktivizimi i antenave nuk mund të merret si provë e sigurt për vendndodhjen e të pandehurit ditën kritike në vendin ku ishte gjetur trupi i pajetë i të ndjerës, kjo posaçërisht duke marrë parasysh raportin e policisë të datës 27.12.2020 me të cilën ishin bërë thirrjet pikërisht nga vendi "K. i L." dhe atë njëmbëdhjetë thirrje të realizuara nga numri i telefonit 045-...-... në numrin e telefonit 045-...-... e që nga raporti nga ana e PTK-Vala del se edhe pse thirrjet ishin bërë nga i njëjti lokacion- "K. i L.", megjithatë janë aktivizuar antena të ndryshme, përkatësisht ishin aktivizuar antenat: V. G-3, C.-G-3, D. G-3, D. G-1, K.-1 dhe Gj.-P.-3, por asnjëherë nuk ishte aktivizuar edhe antena e Z., e kjo duke e ndërlidhur edhe me raportin tjetër të PTK-Vala që është theksuar fakti se aktivizimi i cellave-antene ndërlidhet me disa faktorë dhe nuk mund të merret e sigurt se aktivizimi i një antene edhe të vërtetojë prezencën e personit në atë vend. Të gjitha këto antena mund të aktivizohen për

realizim të thirrjes sepse pika e përafërt që është marrë në këtë rast është në lartësi të madhe në bjeshkë dhe në atë zonë mund të shërbehet nga sinjale të shumta dhe kur bëhet thirrja ka gjasa që të ndryshon thirrja në cell të ndryshëm, në diferencë të shkurtër kohore, ngase në një cell ku tentohet të bëhet thirrje dhe ai cell ka një problem të shkurtër teknikë, apo një ngarkesë thirrja do të tentohet të bëhet në një cell tjetër.

Përmes këtyre provave përjashtohet çfarëdo ndërlidhje se aktivizimi i një antene të caktuar në këtë rast i antenës Z., në telefonatën e të pandehurit me datë 09.11.2015 në ora 15:19, nënkupton edhe prezencën e tij në afërsi të këtij vendi. Është e pashpjegueshme për Gjykatën Supreme të Kosovës se si këto prova vendimtare gjykata e shkallës së parë nuk iu kushton fare vëmendje edhe pse i liston si prova të administruara, por fare nuk merret me çmuarjen e besueshmërisë, fuqisë provuese dhe rëndësisë së tyre. Përtej kësaj edhe gjykata e shkallës së dytë e mbulon gabimin e gjykatës së shkallës së parë duke i dhënë vlerë provuese vetëm raportit të parë të PTK-Vala të viti 2018, dhe njëkohësisht duke anashkaluar raportet e mëvonshme të PTK-Vala, dhe për më tepër, është e pashpjegueshme se si gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj nuk bën asnjë analizë e raporteve të reja të PTK-Vala dhe të cilat raporte e ndryshojnë në tërësi gjendjen dhe raportin e parë e bëjnë në tersi jo relevant.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se edhe kjo provë u keqinterpretuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe kjo duke u ndërlidhur edhe me ekspertizën mjeko-ligjore dhe raportin e autopsisë dhe gjithashtu edhe deklarimin e ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. N.U. (faqja e tretë e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor i datës 29.01.2019) dhe i cili ka dhënë konkludim se nuk është vërtetuar në mënyrë të saktë koha e vdekjes, tani të ndjerës, por “...bazuar në të gjitha këto shenja kufumore mund të deklaroj me besueshmëri të lartë shkencore se koha e vdekjes ka qenë 20 deri 30 ditë, minimumi rreth një muaj para se të kryhet autopsia”. Kurse konstatimi i gjykatës së shkallës së parë në faqen 45 të aktgjykimit se “...e që dita e zhdukjes së D. ishte edhe dita e vrasjes së të njëjtës...” është konstatim në tërësi i pabazuar dhe i pambështetur në asnjë provë e aq më pak nga ekspertiza mjeko-ligjore, raporti i autopsisë, por as nga dëgjimi i ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. N.U., deklarimi i të cilit u citua më lartë. Pra një konkludim i tillë është tërësisht i pabazuar në provat e administruara, meqë asnjëherë nuk ishte konfirmuar koha e saktë e vdekjes së të ndjerës për shkak të rrethanave se nga zhdukja e saj deri në gjetjen e trupit kishte kaluar një kohë e gjatë dhe përmes asnjë metode shkencore nuk mund të vihet në përfundim se dita e zhdukjes ishte edhe dita e vdekjes, siç pa asnjë mbështetje konstatohet nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar edhe mbrojtjen e të dënuarit, por, nuk ka dhënë arsye se pse nuk i besoi versionit të mbrojtjes së tij. Në këtë pikë janë të rëndësishme të potencohen tri aspekte: se pari, i njëjti natyrshëm e ka mohuar kryerjen e kësaj veprë penale që është më se e pritshme kur bëhet fjalë për një veprë të kësaj natyre, së dyti, është e rëndësishme të potencohet fakti se i njëjti pos tri deklarimeve gjatë procedurës hetimore gjatë pjesës tjetër të procedurës zgjodhi të drejtën të mbrohet në heshtje, dhe se treti i njëjti për herë të parë u dëgjua pas një periudhe të gjatë kohore nga zhdukja e të ndjerës, pra dëgjimi i tij në polici u bë me datë 22.12.2015, dhe atë në cilësi të dëshmitarit, përkatësisht 46 ditë nga ngjarja e ndodhur. Por, kjo kohë e gjatë e kaluar duket se nuk ka qenë objekt i vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, për faktin se vlerësohet çdo detaj i mbrojtjes së tij, por, nuk i bëhet analizë kontekstit kohor të mbrojtjes së tij q; gjithsesi është faktor që ka ndikim në saktësinë dhe kujtesën e disa rrethanave për këtë ngjarje. Megjithatë, sipas Gjykatës Supreme të Kosovës kjo mënyrë e vlerësimit të mbrojtjes së të dënuarit nuk është bërë në përputhje me dispozitat e KPP-së, meqë, gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë një ndarje të qartë të deklaramit të të pandehurit si dëshmitar (intervistë të cilën e ka dhënë me 22.12.2015) dhe si i pandehur (23.12.2015) dhe procesverbali për marrje të deklaratës në procedurë paraprake (02.06.2017), pra, tri deklaramit e tij një si dëshmitar dhe dy të tjerat si i pandehur, i ka vlerësuar bashkërisht, dhe për më tepër, me rastin e dëgjimit në Prokurorinë Themelore në Pejë, pjesa më e madhe e mbrojtjes së të pandehurit është marrë duke bërë ballafaqimin me deklaramit e tij në polici dhe provat e nxjerra gjatë periudhës së hetimit, përkundër faktit se kishin kaluar rreth një e vit e gjysmë nga deklarimi i tij i parë. Përveç kësaj, duke anashkaluar këtë situatë dhe duke i marrë parasysh dy deklaramit e tij në cilësi të pandehurit rrjedh se i njëjti ka qenë konsistent në mbrojtjen e tij duke mohuar kryerjen e veprës penale.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se mbrojtja e të pandehurit ka disa mospërputhje me provat e tjera të administruara, por, dy çështje janë të rëndësishme për tu kushtuar vëmendje. Së pari, mbrojtjes së tij se ditën kritike kishte pohuar faktin se kishte qenë me vajzën e tij në Zyrën e Regjistrimit Civil për lidhjen e kurorës-martesës së vajzës së tij dhe mbrojtjes së tij se kishte qenë pjesëmarrës në varrimin e Sh.Z., që kishte ndodhë me datë 09.11.2015, pikërisht në ditën e zhdukjes së të ndjerës. Sa i përket çështjes së parë pa dyshim se i pandehuri mund edhe të ketë gabuar me ditën e shkuarjes në Zyrën e Regjistrimit Civil, pasi që shkuarja e vajzës së tij dhe kurorëzimi i saj kishte ndodhur dy ditë më vonë, pra, me datë 11.11.2015 (e vërtetuar nga raporti i hetuesit i datës 06.03.2017 dhe raporti i Zyrës së Regjistrimit Civil të fshatit S. i E.-D.) e që

duke e ndërlidhur me kohën e gjatë prej 46 dite nga zhdukja e të ndjerës e deri në deklarin e parë të të pandehurit edhe mund të paraqiten gabime duke marrë parasysh kohën e kaluar nga ngjarja e deri te deklarimi i tij. Përtej kësaj duhet shtuar se i pandehuri pohoi faktin se ditën kritike kishte shkuar në ZRC në orët e paradites, me qëllim të njoftimit rreth dokumentacionit të nevojshëm për kurorëzimin e vajzës së tij, e që kjo kohë nuk mund të jetë e sigurt se ka ndodhur pikërisht ditën kritike për shkak të faktorit kohë (nga dita e shkuarjes deri te dita e deklarin të tij në polici kishin kaluar 46 ditë). Pastaj, e rëndësishme në këtë çështje është edhe ndërlidhja e deklarin të të pandehurit dhe raportit të hetuesit të marrë në ZRC nga ana e zyrtarëve përgjegjës përkitazi me praninë e të pandehurit në këtë zyre, e që sipas raportit në fjalë del se i pandehuri nuk kishte pasur ndonjë aktivitet të regjistruar në librat përkatës, por, se edhe nga vet deklarimi i tij pohohet fakti se i njëjti në këtë zyre ishte vetëm për qëllim të informimit për dokumentacionin e nevojshëm për kurorëzimin e vajzës së tij dhe jo për marrjen e dokumentacionit, pasi që kurorëzimi i vajzës së tij edhe nga raporti në fjalë del se ishte bërë me datë.11.11.2015.

Kurse, në këtë kontekst është e rëndësishme të trajtohet raporti i policit hetues të datës 22.12.2015 dhe atë raporti i syzimit mes të dyshuarit N.P. dhe vajzës së tij - dëshmitares A.P., dhe i cili raport ka disa të meta të natyrës procedurale: së pari ky syzim është bërë pas dëgjimit të N.P. në cilësi të dëshmitarit, pra i njëjti fillimisht ishte intervistuar si dëshmitar (procesverbali i datës 22.12.2015), i njëjti ende nuk kishte statusin e të dyshuarit e as të pandehurit në procedurë, që del se syzimi-ballafaqimi është bërë mes dy dëshmitarëve. Raporti në fjalë ka edhe mospërputhje kohore për faktin se koha e përpilimit të raportit del të jetë data 22.12.2015 në ora 21:00 dhe aty shënohet “...pas marrjes së deklaratave nga i dyshimti dhe dëshmitares...” e që ky raport përmban pasaktësi për faktin se i pandehuri N.P. me datë 22.12.2015 ishte dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, kurse dëshmitarja A.P., është dëgjuar në cilësi të dëshmitares me datë 22.12.2015, por, intervista i saj kishte përfunduar me në ora 21:45 minuta, pra, pas përpilimit të raportit që rrjedh se e njëjta një herë është ballafaquar e pastaj është dëgjuar si dëshmitare.

Përtej këtyre aspekteve, del se raporti në tersi është përpiluar në kundërshtim me dispozitën e nenit 123 par.1 të KPP-së i cili ishte në fuqi në kohën e marrjes së këtij veprimi, përkatësisht nenit 119 par.1 të KPP-së që aktualisht është në fuqi, pasi që nuk ekziston dispozitë ligjore që lejon këtë mënyrë të raportit dhe aq më tepër që ky raport të ketë statusin e provës në procedurë penale, për më tepër dispozita e nenit 119 par.1 të KPP-së -123 par.1 të KPP-së (që ka qenë në fuqi në kohën e ndërmarrjes së këtij veprimi), ka përcaktuar që gjatë fazës së hetimit mund të

merren prova nga dëshmitarët në tri mënyra dhe atë: marrja në pyetje në procedurë paraprake, marrja e deklaratës në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë, pra mënyra e përpilimit të këtij raporti del të jetë në kundërshtim të plotë me këto dispozita ligjore. Por, pa marrë parasysh faktet e lartë cekura, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se raporti duhet të trajtohet në tërësinë e tij dhe jo në mënyrë fragmentare, siç kanë bërë dy instancat e ulëta gjyqësore, të cilat i kanë dhënë rëndësi vetëm deklaramit të dëshmitares se ditën kritike nuk ka qenë në ZRC, por vetëm disa rreshta më poshtë pohon faktin se mund të jenë përzier datat dhe që kjo korrespondon edhe me deklaramin e të pandehurit se kishte shkuar në ZRC për marrjen e informatave me qëllim të kompletimit të dokumentacionit për kurorëzimin e vajzës së tij. Natyrshëm se kjo shkuarje e të pandehurit për informata nuk ishte regjistruar në librat e regjistrimit, siç pohuan edhe zyrtarët e ZRC-së, të cilët informatat e tyre i bazuan në regjistrat e nxjerrjes së dokumenteve dhe jo në shkuarjen e të pandehurit në këtë Zyre.

Për më tepër, është e diskutueshme qasja e Prokurorisë së Shtetit përkitazi me këtë raport pasi që ishte një qasje e njëanshme dhe tërësisht jo objektive, mjafton të theksohet fakti se në përpilimin e këtij raporti morën pjesë prokuroria e shtetit dhe disa policë hetues, por me këtë rast kishte mbetur e paqartë pozita e personit N.P. pasi që në këtë fazë ishte dëgjuar vetëm si dëshmitar dhe pastaj ishte përpiluar raporti, pra fillimisht do të duhej që personi të merrte statusin e të pandehurit dhe pastaj do të ishte e arsyeshme edhe caktimi i një mbrojtësi për të pandehurin për një veprim kaq të rëndësishëm procedural, krejt kjo me qëllim të balancimit të palëve në procedurë, siç është shprehur GJEDNj në disa vendime të saj:; “...se duhet të ketë barazi të krahëve ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes...” rasti Jasper & Britanisë së Madhe nr.27052/95&51, për të vazhduar tutje se: “... parimi i barazisë së krahëve kërkon një balancë të drejtë midis palëve ku secilës palë duhet t’i jepet mundësia e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj në kushte që nuk vendosin atë në disavatazh të konsiderueshëm vis-a-vis kundërshtarit të saj...”- Batsanina& Ruisë nr.3932/02&22. Përndryshe kjo qasje e balancimit të palëve kërkohet në të gjitha fazat e procedurës penale: “...një gjykim i drejtë nuk do të thotë se neni nuk zbatohet në procedimet para gjyqësore...”- Imbrioscia & Zvicrës nr.36 Seria A nr.275, si dhe “...me qëllim që e drejta për një gjykim të drejtë të qëndrojë sa duhet praktike dhe efektive neni 6&1 kërkon që si rregull avokatit t’i jepet akses që në hetimin e parë të dyshuarit nga policia, përveç nëse është e demonstruar nën dritën e rrethanave të veçanta të çdo çështje që ka arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë...”- Salduz& Turqisë nr.36391/02 &50, 55, e që sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës ky balancim nuk ka ndodhur në rastin konkret. Përkundër këtyre që u cekën më lartë edhe sikurse të mos ishte vërtetuar me saktësi të plotë mos shkuarja e të

pandehurit në ZRC, kjo rrethanë nuk mund ta ndërlihdh me automatizëm të pandehurin me kryerjen e veprës penale.

Kurse, fakti i pjesëmarrjes së të pandehurit në varrimin e Sh.Z. është i diskutueshëm për faktin se vetëm dy dëshmitar (K.P. dhe Z.Z.) pohuan këtë fakt, kurse dëshmitarët e tjerë e mohuan se kishin parë të njëjtin në ditën e varrimit, megjithëse nuk duhet anashkaluar faktin se në varrim kishte pasur numër të madh të pjesëmarrësve, për më tepër personat për të cilët i pandehuri deklaroi se kishte qenë në varrim R.H., A.F. dhe M.I., asnjë nga ta nuk ishin dëgjuar si dëshmitar. Por, pa marrë parasysh këtë, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se edhe nëse do të vërtetohej me siguri të plotë fakti se i pandehuri nuk kishte marrë pjesë në varrim, megjithatë kjo nuk e ndërlihdhë automatikisht të pandehurin me kryerjen e vrasjes së të ndjerës. Është e rëndësishme të theksohet fakti se në këtë çështje penale nuk ka pasur asnjë provë e cila në mënyrë direkte ka vërtetuar se i pandehuri ka kryer këtë veprë penale, për më tepër, edhe provat indirekte që janë administruar nuk kanë mbyllur qarkun e pamundësisë që kryes i kësaj vepre penale të jenë edhe persona të tjerë dhe kjo argumentohet me disa prova që gjenden në shkresat e lëndës, por se hetimet në këtë drejtim të tyre janë anashkaluar dhe njëkohësisht duke u përqendruar kah tani i pandehuri.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se nga provat e administruara nga ana e gjykatës së parë nuk është vërtetuar se autori i veprës penale ishte i pandehuri dhe siç është theksuar në këtë çështje penale nuk ka pasur prova të drejtpërdrejta, por skema e ngjarjes është ndërtuar duke u bazuar në prova rrethore duke u ndërlihdhur hallkat e zinxhirit të ngjarjes. Për këtë arsye është e rëndësishme të theksohet fakti se për gjykimin e një rasti bazuar në prova rrethore gjithmonë është i nevojshëm standardi i vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm dhe i cili përmbushet vetëm atëherë kur përfundimi i nxjerrë nga këto prova është i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxjerrët prej provave të paraqitura. Pra, duhet të sigurohen prova që të mbyllet qarku, përkatësisht të përjashtohet mundësia që personat e tjerë të jenë kryes të veprës penale. Por, cili është zinxhiri në rastin konkret dhe a u mbyllën të gjitha mundësitë për të ardhur në përfundim se i pandehuri ishte kryesi i kësaj vepre penale gjithmonë duke pasur parasysh përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë: *“...kur ofrohet në afërsi të shtëpisë së N.J., kalon i akuzuari me veturën e tij “J.Sh.”, me ngjyrë të kaltër – mbyllët, i cili ndalet e merr viktimën me veturë e më pas vazhdon në drejtim të Bjeshkëve të S. dhe me të arritur tek vendi i quajtur “K. i L.” e privon nga jeta në atë mënyrë që nga arma e tipit të panjohur ka shtënë duke e qëlluar dy herë në kokë dhe largohet nga vendi i ngjarjes...”*

Në fakt rrethana e parë e këtij zinxhiri ishte çështja se a kishte hipur e ndjera në automjetin e të pandehurit e pastaj të vazhduar më tutje me shtjellimin e rrethanave tjera, përkatësisht vazhdimin e udhëtimit në drejtim të vendit të quajtur “K. i L.”, dhe pastaj ekzekutimi i të ndjerës me armë të tipit të panjohur duke e qëlluar dy herë në kokë. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, në rastin konkret zinxhiri është shkëputur që në hallkën e parë, meqë nuk u vërtetua fakti vendimtar se e ndjera kishte hipur në automjetin e të pandehurit e vërtetuar përmes: ekspertizës së ADN e përpiluar nga ana e AFK-së e datës 15.02.2016 në të cilën është konstatuar se në vendin e ngjarjes nuk ka përputhshmëri me mostrat e marra të të pandehurit, raporti i laboratorit të FBI-së në V.. të SHBA me nr....-SRv...-. numri i laboratorit ...-....-. i datës 06.07.2016, ku konstatohet se nuk është provuar se qimet e flokut apo qimet e tjera që janë tërheqë nga vetura e të akuzuarit të kenë çfarëdo lidhje me viktimën D.P. dhe përjashtimin e mundësisë se e ndjera ishte në automjetin e të akuzuarit e bën edhe raporti i ekspertizës nga Laboratori i Kriminalistikës të TNP-së në Ankara të Turqisë me numër referues YDPO-../.../...-DG i datës 16.05.2015, sipas së cilit vërtetohet se nga shikimi në incizime nuk ka mundur të bëhet identifikimi i tabelave si dhe identifikimi i personave në automjet. Kjo përforcohet edhe përmes raportit të AFK-së të datës 02.12.2020 që nuk vërtetohet madje as hapja dhe mbyllja e derës së automjetit në vendin ku pretendohet se e ndjera ka hipur në automjetin e të pandehurit, dhe gjithashtu asnjë nga dëshmitarët e dëgjuar nuk ka konfirmuar një gjë të tillë, ashtu që duke marrë parasysh se nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme hipja e të ndjerës në automjet, atëherë me këtë bëhet i panevojshëm shtjellimi i mëtejme i hallkave tjera që ndërlidhin të pandehurin me këtë vepër penale.

Në fillim të pjesës arsyetuese, Gjykata Supreme e Kosovës vuri në pah zgjatjen e këtij procesi gjyqësor për rreth tetë vite dhe e cila zgjatje pa dyshim se duhet t'i atribuohet edhe prokurorisë së shtetit e cila e zhvilloi fazën e hetimeve në këtë çështje penale dhe del se nuk janë zhvilluar hetime të plota dhe gjithëpërfshirëse. Ku më së miri pasqyrohet me faktin se disa herë kjo çështje penale është kthyer në rigjykim me shkas që të merren prova të reja dhe kjo ka rezultuar me marrjen e provave të reja nga ana e gjykatave të shkallëve të para dhe të cilat prova edhe janë marrë me qëllim të ndriçimit të kësaj çështje penale. Për më tepër, bazuar në shkresat e lëndës, vërehet fakti se prokuroria e shtetit nuk ka ezauruar të gjitha pistat e mundshme të hetimit për vrasjen e tani të ndjerës, por shumë të dhëna të rëndësishme nga faza hetimore nuk u nisën fare apo ato që u nisën nuk u vazhduan dhe veçanërisht dyshimet e para që janë pjesë e shkresave të lëndës dhe të dhënat që paraqitën familjarët e të ndjerës përmes deponimeve të tyre dhe disa dyshime që rrjedhën edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe kjo lehtë vërtetohet me një

shfletim të thjeshtë të shkresave të procedurës paraprake para se të zbulohet trupi i të ndjerës dhe të vërtetohet se ishte privuar nga jeta, por edhe gjatë zhvillimeve të shqyrtimeve gjyqësore.

Tutje Gjykata Supreme e Kosovës vëren faktin se në dritën e këtyre rrethanave një aspekt i rëndësishëm paraqet fakti i personalitetit të të pandehurit me vet faktin se i njëjti ishte dënuar një herë për vrasje të rëndë dhe kjo padyshim se ishte rrethanë me ndikim edhe në epilogun e dy instancave më të ulëta gjyqësore e që kjo gjithsesi konsiderojmë se shkeli parimin e prezumimit të pafajësisë, siç është konstatuar në disa raste nga ana e GJEDNJ e që ndër to do t' i referohemi rastit *Allenet De Ribemont & Francës*, aktgjykimi i datës 10.02.1995, seria A, NO 308, ku theksohet se: *“Se e rëndësishme është se prezumimi i pafajësisë nga neni 6/2 të KEDNJ, nuk përfshinë ndalesën që gjykata të informohet me të dhënat mbi çështje gjyqësore të të pandehurit nga evidenca e të dënuarve. Në parim gjykata nacionale mund të informohen mbi të gjitha rrethanat, të cilat janë të ndërlidhura me personalitetin e të pandehurit dhe që mund të kenë ndikim në matjen e dënimit, por jo në vërtetimin e përgjegjësisë penale”*, siç në fakt është vepruar në rastin konkret ku pikërisht e kaluara e tij ka qenë edhe bazë për fajësinë e tij.

Kurse në rastin tjetër për të kuptuar më mirë shkallën e shtrirjes së këtij prezumimi kjo gjykatë në rastin *Nolkenbockhoff & Gjermanisë* -aktgjykimi i GJEDNJ, të datës 25.08.1987, serie A 123 shprehet: *“ I pandehuri ka vdekur pasi që është marrë aktgjykimi dënues kundër të cilit është ushtruar ankesë. Trashëgimtarët e tij kanë kërkuar nga shteti kompensimin e shpenzimeve të mbrojtjes gjatë procedurës, mirëpo gjykata gjermane kërkesë padinë e tillë e ka refuzuar me arsyetimin se gjykata e shkallës së dytë sigurt se do ta kishte vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë”*. Pra, rrjedhimisht në të dy këto raste është konstatuar se me një qëllim të tillë është shkelur prezumimi i pafajësisë të cilin e garanton neni 6/2 i GJEDNJ.

Në përmbyllje të këtij aktgjykimi, Gjykata Supreme e Kosovës shpreh shqetësimin e saj përkitazi me standardin e aplikuar së pari nga ana e Prokurorisë së Shtetit e mbështetur pastaj nga ana e dy gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore, të cilat përdorën një standard minimal të të provuarit dhe kundruall kësaj shqiptuan dënim maksimal dhe atë pa një vlerësim dhe analizë të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirëse të provave që ishin në shkresat e lëndës dhe njëkohësisht duke bërë interpretim të gabuar të ligjit penal. Për më tepër, edhe sikur disa rrethana të ishin argumentuar me prova të sigurta (mëqenëse siç u tha më lartë kjo nuk ka ndodhur), pra nuk është argumentuar me prova të sigurta por në supozime dhe hamendësime, megjithatë kjo do të ishte e mjaftueshme për të ndërtuar pista hetimesh, por në asnjë rrethanë për të ngritur

aktakuzë e aq më pak për shpalljen fajtor dhe gjykimin e të pandehurit. Me këto veprime del se janë shkelur rregullat bazike të prezumimit të pafajësisë të garantuara *përmes mekanizmave të brendshëm* neni 31 par.5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 3 i KPP-së, meqë gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të të pandehurit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë *“in peius”* ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë *“in favorem”* ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet, *si dhe përmes mekanizmave të jashtëm* KEDLNj dhe GJEDLNj e së ndërtuar përmes vendimeve të saja: Minelli & Zvicrës, Murray & Britanisë së Madhe, Tefler & Austrisë, Lavents & Letonisë, etj., në të cilat vendime rëndësi vendimtare i kushtohet parimit të prezumimit të pafajësisë, përkatësisht kërkesës që kryerja e detyrave nga ana e anëtarëve të një gjykate nuk duhet të filloj me idenë e paracaktuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të akuzuarit.

Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje të ligjit penal dhe të cilat shkelje nuk janë mënjeluar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë e cila vendosi sipas mjetit të rregullt juridik dhe për këtë arsye u vendos që konform nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.57/2023, më 6 prill 2023

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka